

Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren – RrOK Prizren

23 qershor 2012, Prizren

KOMUNIKATË PËR MEDIA Rrjetëzimi i kulturës së pavarur në Prizren

U themelua Rrjeti i Organizatave të Kulturës në Prizren. Ky është rrjet joformal i organizatave dhe aktivistëve të kulturës në komunën e Prizrenit. Misioni i këtij Rrjeti është arritja e një ekonomie të zhvilluar lokale në Prizren përmes pasurimit dhe strukturimit të ofertës turistike bazuar në rritjen e cilësisë dhe sasisë së aktiviteteve kulturore. Objektivat themelore të punës së Rrjetit në Prizren përfshijnë: pasurimin e jetës kulturore, ngritjen e cilësisë së aktiviteteve ekzistuese kulturore, strukturimin e ofertës kulturore, përmirësimin e politikave kulturore në nivel komunal, menaxhimin e decentralizuar të kulturës, diversifikimin e financimit të aktiviteteve kulturore dhe nxitjen e qytetarisë aktive dhe të përgjegjshme.

Anëtarësia e Rrjetit përbëhet nga organizatat jo-qeveritare të kulturës (dhe fushave ndërlidhëse), artistët dhe aktivistët e kulturës. Anëtarësia e Rrjetit nuk do të jetë e kufizuar dhe ajo do të zgjerohet gjatë gjithë kohës me përfshirjen e anëtarëve të ri. Mënyra e organizimit të Rrjetit do të jetë joformale (rrjet i paregjistruar) dhe do të ketë vetëm një Sekretariat që do të jetë përgjegjës për organizimin e Rrjetit dhe implementimin e projekteve dhe aktiviteteve të tij.

Veprimet konkrete të Rrjetit do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen me aktivitetet vijuese: përpilimi dhe promovimi i kalendarit kulturor dhe turistik të Prizrenit, ngritja e fondeve për aktivitetet e Rrjetit dhe të anëtarëve të tij, avokim për rritjen e buxhetit komunal për kulturën, avokim për miratimin / ndryshimin / parandalimin e legjislacionit kulturor në nivel lokal dhe qendror. Themeluesit e Rrjetit janë: EC Ma Ndryshe, Festivali Dokufest, Fondacioni për Trashëgimi Kulturor, Forumi për Trashëgimi Kulturor, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, GreenArt, X40, Ura e Artit, Durmish Asllano, ICEC, Old timer Club Prizren, Shoqata e Bjeshkatarëve Sharri, Leo's Art Organization dhe Xhennet Comics.

Aktivitetet e para të Rrjetit, të cilat do të realizohen gjatë vitit 2012 janë:

- Kalendarit kulturor turistik i Prizrenit,
- Hulumtimi mbi kapacitetet dhe nevojat e sektorit të kulturës së pavarur në Prizren,
- Strategjia për kulturë (dhe turizëm kulturor) e Prizrenit,
- Debati mbi politikën kulturore lokale (që do të mbahet më 9 korrik 2012, në orën 17.00 në Hamamin e Gazi Mehmet Pashës në Prizren)

Rrjeti i Organizatave të Kulturës do të vazhdojë të mbajë të informuar publikun mbi të gjitha aktivitetet e zhvilluara, përmes takimeve me gazetarë dhe komunikatave për media.

Ju falemnderit për hapësirën e ofruar dhe bashkëpunimin tuaj.

Me respekt,

Në emër të Rrjetit të Organizatave të Kulturës në Prizren
Hajrulla Çeku, EC Ma Ndryshe